



PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, DONALD TRUMP, KA NËNSHKRUAR AKTIN E AUTORIZIMIT TË MBROJTJES KOMBËTARE (NATIONAL DEFENSE AUTHORIZATION ACT), KU PËRFSHIHET EDHE KOSOVA

LIGJI AMERIKAN GARANTON KUFIJTË E KOSOVËS, NJOHJEN RECIPROKE DHE ZGJERIMIN E NATO-s



Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka nënshkruar Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare, i cili autorizon më shumë se 901 miliardë dollarë për programet e mbrojtjes dhe përfshin edhe Kosovën. Ky ligj pasqyron rëndësinë që Shtëpia e Bardhë dhe Kongresi i Shteteve të Bashkuara i kushtojnë sigurisë së Kosovës dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor. Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka theksuar se si ligj federal, i dekretuar nga presidenti Trump, ai përligj së paku tri garanci të rëndësishme për Kosovën dhe Ballkanin: nuk ka ndryshim kufijsh në rajon, marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë do të përmbyllet me njohje reciproke, zgjerimi i NATO-s në Ballkan do të vazhdojë, përfshirë edhe mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në aleancën veriatlantike

SHBA-ja KËRKON ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË OHRIT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË F. 4



KURTI MIRËPRET HEQJEN E MASAVE, THOTË SE NUK KANË QENË ASNJËHERË TË HIDHËRUAR ME BE-në F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



DRITA SHKRUAN HISTORINË, SIGURON FAZËN E "PLAY-OFF"-it NË LIGËN E KONFERENCËS F. 11



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, DONALD TRUMP, KA NËNSHKRUAR AKTIN E AUTORIZIMIT TË MBROJTJES KOMBËTARE (NATIONAL DEFENSE AUTHORIZATION ACT), KU PËRFSHIHET EDHE KOSOVA

LIGJI AMERIKAN GARANTON KUFIJTË E KOSOVËS, NJOHJEN RECIPROKE DHE ZGJERIMIN E NATO-s

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka nënshkruar Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare, i cili autorizon më shumë se 901 miliardë dollarë për programet e mbrojtjes dhe përfshin edhe Kosovën. Ky ligj pasqyron rëndësinë që Shtëpia e Bardhë dhe Kongresi i Shteteve të Bashkuara i kushtojnë sigurisë së Kosovës dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.

Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka theksuar se si ligj federal, i dekretuar nga presidenti Trump, ai përligj së paku tri garanci të rëndësishme për Kosovën dhe Ballkanin: nuk ka ndryshim kufijsh në rajon, marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë do të përmbillet me njohje reciproke, zgjerimi i NATO-s në Ballkan do të vazhdojë, përfshirë edhe mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në aleancën veriatlantike

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 19 dhjetor - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka nënshkruar Aktin e Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare (National Defense Authorization Act), i cili autorizon më shumë se 901 miliardë dollarë për programet e mbrojtjes dhe përfshin edhe Kosovën. Ky ligj pasqyron rëndësinë që Shtëpia e Bardhë dhe Kongresi i Shteteve të Bashkuara i kushtojnë sigurisë së Kosovës dhe stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.

Akti i Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare përmban disa mesazhe si paqja, stabiliteti dhe se e ardhmja demokratike e Kosovës janë interes strategjik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. “Akti i Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare: Mbështet zgjerimin e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, përfshirë perspektivën e anëtarësimit të Kosovës në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Mbështet qartë marrëveshjen për normalizimin Kosovë-Serbi dhe bën thirrje për zbatimin e saj real. Konfirmon se objektivi përfundimtar është njohja e ndërsjellë. Refuzon çdo ide për ndarje, shkëmbim terriroresh apo ndryshim kufijsh mbi baza etnike. Forcon mbështetjen e ShBA-së për demokracitë e Ballkanit Perëndimor dhe procesin e tyre të anëtarësimit në Bashkimin Evropian”.

Në një nga pikat e rëndësishme të dokumentit është qëndrimi zyrtar i Kongresit amerikan për dialogun Kosovë - Serbi. Aty Marrëveshja e 2023-s për normalizimin e marrëdhënieve konsiderohet hap pozitiv, ndërsa kërkohet përparim i menjëhershëm në Aneksin e zbatimit. Riafirmon se zgjidhja përfundimtare duhet të bazohet në njohje reciproke dhe kundërshton qartë çdo ide për ndarje territoriale, shkëmbime apo rishikim kufijsh mbi baza

etnike.

Mbështet, gjithashtu, zgjerimin e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë edhe perspektivën e anëtarësimit të Kosovës në Aleancë, si dhe anëtarësimin në BE.

Në Ligj parashikohet mbështetje e vazhdueshme për reformat demokratike dhe sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor, zhvillimin ekonomik, rritjen e investimeve dhe forcimin e institucioneve. Kosova po ashtu përfshihet në kuadrin rajonal të masave për monitorimin dhe kundërshtimin e ndikimit malinj rus dhe kinez në Ballkanin Perëndimor. Ligji mbështet rritjen e ndihmës amerikane për sigurinë kibernetike, nga e cila përfiton edhe Kosova.

Legjislacioni gjithëpërfshirës përcakton gjithçka, nga sa anije, avionë dhe sisteme raketash blihen nga ShBA-ja, te një rritje pagash për trupat, e deri te mënyra e adresimit të kërcënimeve gjeopolitike. Ai është një kompromis, që kombinon masa të veçanta të miratuara nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati, të dyja nën kontrollin e republikanëve.

Ligji përfshin po ashtu disa dispozita për të rritur sigurinë në Evropë.

Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka shkruar në “Facebook” për hyrjen në fuqi të Ligjit të ShBA-së për autorizimin e mbrojtjes kombëtare, ku përfshihet edhe Kosova. Reka ka theksuar se si ligj federal, i dekretuar nga presidenti Trump, ai përligj së paku tri garanci të rëndësishme për Kosovën dhe Ballkanin: nuk ka ndryshim kufijsh në rajon; marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë do të përmbillet me njohje reciproke; dhe zgjerimi i NATO-s në Ballkan do të vazhdojë, përfshirë edhe mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në aleancën veri-



atlantike.

“Ligji rikomfirmon kontinuitetin e politikës amerikane për Kosovën, në katër dekadat e fundit, nga dokumenti i parë i Stejt Departamentit i vitit 1986: ‘Kosovo Republic Project’, të cilin e sjell në librin e tij Fron Nahzi (‘Ethnic Interest Groups and US Foreign Policy’), që del nga shtypi këto ditë. Republika e Kosovës nuk mund të bëhej pa SHBA, e as të funksionoj pa Amerikën. Ndërkaq Kosova mbetet shteti më pro-amerikan”, ka shkruar ambasadori Reka.

Ligji ri i nënshkruar nga Trumpi përmend 11 herë Kosovën, Petrit Selimi tregon pikat kryesore në lidhje me vendin tonë

Në Aktin për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare që u miratua nga dy dhomat e Kongresit Amerikan dhe u nënshkrua në ligj nga

presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, më 18 dhjetor, Kosova u përmend 11 herë, thotë ish-ministri i Jashtëm, Petrit Selimi.

Selimi tha se qëndrimi më i rëndësishëm që u shpalos këtu është që ShBA vazhdon të mbështesë një marrëveshje përfundimtare me njohje reciproke Kosovë - Serbi dhe se nuk mbështet politikën e rishkrimit të kufijve.

“Senati/Dhoma e Përfaqësuesve të ShBA-së miratoi projektligjin e mbrojtjes. Fokusi kryesor është padyshim buxheti prej 901 miliardë dollarësh, por Kosova përmendet 11 herë në ligj. Cilat janë pikat kryesore në lidhje me Kosovën? Marrëveshja e Ohrit është një hap pozitiv përpara në avancimin e normalizimit midis Kosovës dhe Serbisë....Serbia dhe Kosova duhet të synojnë të bëjnë përparim të menjëhershëm në zbatimin e Marrëveshjes së

Ohrit. Sapo të jetë bërë përparim i mjaftueshëm në zbatimin e saj, ShBA-të duhet të marrin në konsideratë avancimin e iniciativave për të forcuar marrëdhëniet dypalëshe dhe dialogët strategjikë me Kosovën dhe Serbinë... Më e rëndësishmja, ‘Shtetet e Bashkuara duhet të vazhdojnë të mbështesin një marrëveshje përfundimtare gjithëpërfshirëse midis Kosovës dhe Serbisë bazuar në njohjen reciproke’, por gjithashtu: ‘nuk do të ndjekin asnjë politikë që mbështet shkëmbimin e territoreve, ndarjen ose rivizatimin e kufijve përgjatë vijave etnike’...Pika të tjera lidhen me Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë disa aspekte mbi mbështetjen ekonomike për rajonin, me synim rritjen e ndërlidhjes dhe uljen e varësisë energjetike nga energjia ruse - një mesazh i qartë për Serbinë”, ka theksuar Selimi, ish-ministër i Jashtëm.

KURTI MIRËPRET HEQJEN E MASAVE, THOTË SE NUK KANË QENË ASNJËHERË TË HIDHËRUAR ME BE-në

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, mirëpriti të premten vendimin e Bashkimit Evropian për heqjen e masave ndëshkuese. BE-ja vendosi masat ndaj Kosovës më 2023 për shkak të tensioneve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Por, Kurti gjatë mbledhjes së ekzekutivit tha të premten se institucionet e Kosovës “nuk ishin shkak të përshkallëzimit të situatës” në veri, por ulja e tensioneve në atë zonë “ishte pikërisht meritë e institucioneve” të shtetit. “Ne e mirëpresim vendimin e Bashkimit Evropian për t’i hequr masat që i ishin vendosur Kosovës. Ato ishin të padrejta që në ditën e parë. Sepse, së pari, institucionet e Republikës së Kosovës nuk ishin shkak të eskalimit të situatës në katër komunat në veri të vendit tonë dhe, së dyti, sepse deeskalimi i situatës ishte pikërisht meritë e institucioneve të Republikës së Kosovës. Ndërkohë, Republika e Kosovës dhe institucionet e saj u bënë cak i sulmeve terroriste, prej të cilave dy me pasoja të rënda: ai në Banjskë të Zvečanit më 24 shtator të vitit 2023, ku mbeti i vrarë rreshteri policor, heroi ynë, Afrim Bunjaku, dhe tjetri në kanal in Ibër-Lepenc në Varagë të Zubin Potokut më 29 nëntor 2024, që synonte dëmtimin e pariparueshëm të infrastrukturës kritike. Për të dy këto sulme, tashmë ka aktakuza të ngritura”, ka theksuar Kurti. Ai ka thënë se për rastin e Banjskës të gjitha provat dëshmojnë për një plan të përgatitur me përfshirjen dhe financimin e shtetit të Serbisë për aneksimin e veriut të Kosovës përmes strukturave paramilitare pas një konflikti që do të zgjerohej. “Po të mos ishin vendimet në kohë dhe reagimi i shpejtë e profesional i njërive tona speciale të Policisë, mëngjesi i 24 shtatorit të vitit 2023 do të na zbardhte një realitet krejtësisht tjetër në terren. Ndërkaq, për sulmin mbi kanal in Ibër-Lepenc, provat e grumbulluara dhe informacionet rreth të arrestuarve gjithashtu konfirmojnë përfshirjen e strukturave ilegale të Serbisë dhe



vetë shtetit të Serbisë. Në retrospektivë, çdo kompromis ndaj sundimit të ligjit do të ishte fatal për Republikën e Kosovës. Situata e qetë, lëvizja e lirshme dhe funksionimi i institucioneve të shtetit në veriun e Kosovës, është pikërisht, sepse ka triumfuar sundimi i ligjit dhe rendi publik”, është shprehur Kurti, duke shtuar se megjithkëto, gjatë gjithë kësaj kohe, si qeveri nuk kanë qenë asnjëherë të hidhëruar me Bashkimin Evropian. “Kemi mbetur plotësisht të përkushtuar ndaj integritetit evropian, për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim dhe për të vazhduar si aleatë dhe kampionë të vlerave demokratike. Por, më duhet të them edhe diçka: Republika e Kosovës, masat më të mëdha financiare, nuk i ka vuajtur nga Bashkimi Evropian, por nga opozita parlamentare. Në muajin e kaluar, përkundër insistimit tonë, Kuvendi i Republikës u shpërnda pa u votuar Plani i Rritjes së BE-së në vlerë prej 880 milionë euro dhe tri marrëveshje me Bankën Botërore në vlerë mbi 120 milionë euro, pra mbi 1 miliard euro gjithsej, në mungesë të vullnetit dhe të votës së

opozitës. Andaj, uroj dhe shpresoj që pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit dhe konstituimit të Kuvendit, edhe opozita e tanishme t’ia heqë masat Kosovës”, ka deklaruar Kurti. Mungesa e konsensusit për krijimin e institucioneve të reja të Kosovës pas zgjedhjeve të shkurtit çoi në shpalljen e zgjedhjeve të reja, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor. Përveç masave ndëshkuese të BE-së, qeveria e udhëhequr nga Kurti është përballur me kritika nga Shtetet e Bashkuara për shkak të disa vendimeve në veriun e shtetit, përfshirë mbylljen e institucioneve serbe, ndërmarrje publike që funksiononin në sistemin serb. Në veri, po ashtu, është ndaluar përdorimi i dinarit serb për kryerjen e pagesave. Serbia ka financuar strukturat paralele në veri dhe ka mbështetur serbët atje përmes pensione dhe shtesave të tjera, në dinarë. Por, institucionet i kanë konsideruar këto veprime në kuadër të shtrirjes së sovranitetit në këtë pjesë të shtetit. ShBA-ja dhe BE-ja i kanë cilësuar shumë nga këto veprime si të pakoordinuara.

Kurti: Kosova forcoi zërin në vendimmarrjen rajonale, CEFTA

Në mbledhjen e qeverisë pikë e rendit të ditës ishte edhe propozimi për konfirmimin e obligimit të zbatimit të vendimeve të CEFTA-s dhe të protokolleve të saj. Kryeministri në detyrë, Kurti, ka thënë se në fund të vitit të kaluar, 16 vjet pas shpalljes së pavarësisë, shënuan një arritje historike në CEFTA, duke larguar UNMIK-un e duke siguruar përfaqësim të plotë e direkt të vendit tonë. “Ky hap forcoi zërin e Kosovës në vendimmarrjen rajonale dhe mundësoi udhëheqje aktive në CEFTA 2025, përfshirë zgjedhjen për herë të parë të një drejtoreje shqiptare në krye të Sekretariatit. Këtë vit, nën udhëheqjen e Kosovës, morëm 12 vendime. Sot, për vendimmarrje të qeverisë, kemi vendimet që janë aprovuar në Komitetin e Përbashkët të CEFTA-s,

sikurse: tregtinë elektronike dhe bashkëpunimin digjital; barna më të sigurta dhe qasje më e shpejtë në to; mbështetje për bizneset përmes uljes së kostove doganore dhe të përshpejtimin të procedurave doganore; njohje e nënshkrimeve elektronike dhe qasje më e barabartë në shërbime digjitale pa geoblocking; si dhe konkurrencë e drejtë, që sjell zgjedhje më të gjera e çmime më të mira. Të gjitha këto vendime do të zgjerojnë dhe thellojnë tregtinë mes Kosovës dhe rajonit, si dhe qasjen graduale në tregun unik të Bashkimit Evropian. Arritje këto, që përthehen, sigurisht, në më shumë vende pune, shërbime më cilësore dhe një Kosovë në përgjithësi më të sigurt e më prosperuese”, ka thënë Kurti.

Bahamas njeh Kosovën

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Bahamas është bërë shteti i 121-të që njeh Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Lajmin e ka bërë me dije

të premten presidentja Vjosa Osmani. “Urime të gjithë qytetarëve të Republikës sonë! Sapo kemi nënshkruar, këtu në

kryeqytetin e Bahamas, marrëveshjen dypalëshe për njohje dhe vendosje të marrëdhënieve diplomatike me

Kryeministrin e Bahamas, mikun tonë të mirë Philip Davis”, ka shkruar në “Facebook” presidentja Vjosa osmani.





SHBA-JA KËRKON ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË OHRIT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, e arritur në shkurt të vitit 2023 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, përfaqëson një hap pozitiv drejt normalizimit mes dy vendeve, të cilat “duhet të synojnë përparim të shpejtë në zbatimin e Aneksit të kësaj marrëveshjeje”. Kështu thuhet në Aktin për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare që u miratua nga dy dhomat e Kongresit Amerikan dhe u nënshkrua në ligj nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, më 18 dhjetor. “Pasi të arrihet përparim i mjaftueshëm, ShBA-ja duhet të shqyrtojë iniciativa për forcimin e marrëdhënieve bilaterale me të dyja vendet”, thuhet në tekst, duke shtuar se kjo përfshin dialogun strategjik dypalësh dhe nisma konkrete për thellimin e lidhjeve ekonomike dhe investimeve. Sipas aktit, ShBA-ja duhet ta vazhdojë mbështetjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, e bazuar në njohjen e ndërsjellë, duke mos mbështetur shkëmbime territoriale, ndarje apo ndryshime të tjera të kufijve sipas linjave etnike në Ballkanin Perëndimor për zgjidhjen e konflikteve, dhe duhet t'i mbështesë demokracitë pluraliste në rajon si një mjet për ta parandaluar rikthimin e konflikteve etnike. Kjo marrëveshje prej 11 nenesh,

që njihet edhe si Marrëveshja e Ohrit, ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi që t'i zbatojnë edhe të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut. Akti Kombëtar për Mbrojtje për vitin fiskal 2026 autorizon shpenzim vjetor rekord për ushtrinë amerikane që arrin vlerën e 901 miliardë dollarëve, 8 miliardë më shumë seç kishte kërkuar Trumpi. Akti përfshin gjithçka, nga numri i anijeve, avionëve dhe sistemeve raketore që do të blihen e deri te rritja e pagave për ushtarët dhe mënyra se si do të adresohen kërcënimet gjeopolitike. Teksti i këtij dokumenti përmend një sërë çështjesh, përfshirë edhe varësinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor nga energjia ruse. Aty thuhet se kjo varësi lidh ekonomitë dhe politikën e tyre me Moskën dhe pengon aspiratat e tyre për integrim evropian, ndërsa korrupsioni, përfshirë edhe në nivelet e udhëheqësve kryesorë politikë, vazhdon të përbëjë një nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe politik të rajonit. Në Aktin për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare thuhet se ulja e varësisë së Ballkanit Perëndimor nga gazi dhe

karburantet fosile ruse është në interes kombëtar të ShBA-së dhe se Uashingtoni duhet ta mbështesë anëtarësimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian dhe NATO. “Varësia e vendeve të Ballkanit Perëndimor nga burimet fosile ruse dhe gazi natyror lidh ekonomitë dhe politikën e tyre me Federatën Ruse dhe pengon aspiratat e tyre për integrim evropian”, thuhet në këtë dokument. Rritja e ndikimit të Kinës në Ballkanin Perëndimor gjithashtu mund të ketë ndikim të dëmshëm në konkurrencën strategjike, demokracinë dhe integrimin ekonomik me Evropën, thuhet në dokument, ku kërkohet që sekretari i Shtetit, në koordinim me atë të Mbrojtjes, drejtorin e Shërbimit Kombëtar të Inteligjencës dhe agjencitë e tjera përkatëse, t'i raportojë rregullisht Kongresit për ndikimin dashakeq të Rusisë dhe Kinës në vendet e Ballkanit Perëndimor.

“Shqetësim i thellë” për gjendjen e demokracisë në Serbi

Në Aktin për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare është shprehur shqetësim edhe për gjendjen e demokracisë në Serbi. “Zgjedhjet parlamentare dhe lokale të mbajtura në Serbi më 17 dhjetor 2023 dhe pasojat e tyre të menjëhershme ngjallin shqetësim të thellë lidhur me

gjendjen e demokracisë në Serbi, duke përfshirë përfundimet e raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR-it”, thuhet në tekstin e dokumentit. Aty shtohet se Zyra e OSBE-së për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut ka vlerësuar se në ato zgjedhje kishte “kushte jo të drejta” për votim, “shumë mangësi procedurale, përfshirë zbatimin jo të barabartë të masave mbrojtëse gjatë votimit dhe numërimit, mbingarkimin e qendrave të votimit, shkelje të fshehtësisë së votës dhe raste të shumta të votimit në grup”. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë gjithashtu ka theksuar se zyrtarët serbë kanë akuzuar kryesisht protestuesit paqësorë, partitë opozitare dhe shoqërinë civile për “përpjekje për ta destabilizuar qeverinë”, një pretendim shqetësues që rrezikon sigurinë e pjesëve të rëndësishme të shoqërisë serbe, thuhet në tekstin e Kongresit, ku vlerësohet se vendet demokratike, të cilat ndajnë vlerat e ShBA-së, përfaqësojnë partneritete më të forta dhe afatgjatë.

Mbështetje për EUFOR-in në Bosnjë-Hercegovinë

Ndër qëndrimet e Kongresit, sipas aktit, është se duhet të mbështetet ruajtja e mandatit të plotë të EUFOR-it në Bosnjë-Hercegovinë, duke e konsideruar këtë në interes

të sigurisë kombëtare të ShBA-së. Gjithashtu, kërkohet që NATO-ja dhe BE-ja ta rishikojnë mandatin dhe vendosjen e misionëve në Bosnjë-Hercegovinë për t'u siguruar që të luajnë një rol proaktiv në krijimin e një mjedisi të sigurt, veçanërisht në fushën e mbrojtjes.

Mbështetje për integrimet euroatlantike

Vendet e Ballkanit Perëndimor - Kosova, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia - përbëjnë një rajon pluralist dhe shumetnik në zemër të Evropës, i cili është thelbësor për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e kontinentit, thuhet në fillim të seksionit kushtuar rajonit, për të cilin u tha se mund të quhet “Ligji për demokracinë dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor”. Paqja, stabiliteti dhe prosperiteti i qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor lidhen drejtpërdrejt me mundësitë për përparim demokratik dhe ekonomik të këtyre gjashtë vendeve, dhe është në interes të përbashkët të ShBA-së dhe vendeve të rajonit të përmirësojnë rritjen dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në rajon. Reformat drejt Bashkimit Evropian, të kryera nga vendet e Ballkanit Perëndimor, kanë sjellë përparim të konsiderueshëm demokratik dhe ekonomik në

AFATET PËR SHMANGIEN E PARALIZËS POTENCIALE TË KOSOVËS PAS ZGJEDHJEVE TË 28 DHJETORIT

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Pakkush u habit kur u mor vesh që Kosova do të shkonte në zgjedhje të parakohshme parlamentare më 28 dhjetor, duke e marrë për bazë krizën politike gjatë gjithë vitit. Por, a është ky proces shpëtim për Kosovën? A mund të shmanget rreziku për paralizën shtetërore që mund ta përjetojë vendi, nëse nuk arrihen afatet e nevojshme kohore deri në marsin e 2026-s? Këtë vit 28 dhjetori përbën të dielën e katërt të zgjedhjeve në Kosovë.

Për shkak të mungesës së konsensusit politik për të krijuar institucione pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, Kosova i organizon zgjedhjet e parakohshme këtë fundvit që, sipas planifikimeve buxhetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kapin shumën e rreth 11.5 milionë eurove.

Duket që KQZ-ja duhet të tregojë efikasitet si asnjëherë më parë, që të mund të arrihen afatet e nevojshme për formimin e një qeverie të re, e që shteti të mos hyjë në një territor të pashkelur më parë.

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë për Radion Evropa e Lirë se nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve, KQZ-së i duhen diku një muaj e gjysmë kohë për t'i kryer të gjitha procedurat. “Besoj që fundi i muajit janar është periudha më ideale kur mund të kemi certifikim të rezultateve zgjedhore, ndonëse rreziku është që një të tillë të mos e kemi deri në mesin e muajit shkurt”. Pas certifikimit, ligji parasheh një afat prej 30 ditësh për konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Por, këtë herë, Kuvendi duket se afat të fundit për konstituim e ka, në fakt, fundin e shkurtit.

Arsyeja? Pozita e presidentit të shtetit. “Data 5 mars është afati i fundit kur Kuvendi duhet ta

zgjedhë presidentin e ri, dhe dështimi eventual mund të provokojë zgjedhje të parakohshme, edhe pa arritur fare të zgjedhja e qeverisë, apo të formimi i institucioneve të reja”, thotë Cakolli.

Pra, partitë politike, përveçse se të dakordohen për institucionet e reja, duhet të dialogojnë edhe për çështjen e kreut të shtetit, pozitë të cilën aktualisht e mban Vjosa Osmani.

Ky post është përmendur shpesh si pjesë e kalkulimeve të subjekteve politike në arritjen e koalicioneve eventuale për bashkëqeverisje.

Një tjetër problem i madh do të ishte mbetja e shtetit pa buxhet. Në pamundësi të miratimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, Kosova do të funksionojë me 1/12 e buxhetit të vitit aktual gjatë dy muajve të parë të 2026-tës.

Në një situatë të atillë, pa një emër të ri të presidentit dhe pa një qeveri të re e buxhet, as KQZ-ja nuk do të mund t'i organizonte zgjedhjet e parakohshme të radhës, në mungesë fondesh, që s'do të kishte kush t'ia ndante.

Megjithatë, Cakolli beson se, nëse partitë do ta ndanin mendjen për bashkëpunim, ky skenar do të shmangej – në rast të kundërt, rreziqet do të ishin të jashtëzakonshme. “Nëse do të ketë vullnet politik për të gjetur zgjidhje, qoftë edhe të përkohshme, atëherë mund të arrijmë në momentin kur Kuvendi miraton një buxhet, apo formohet qeveri kujdestare në atë periudhë. Por, nëse do të ketë mungesë të vullnetit politik, vendimmarrje politike në funksion të vazhdimit të bllokadës, atëherë vendi do të shkojë drejt krizës, unë besoj më të rëndën institucionale ose socio-politike që kemi parë ndonjëherë”.

Në këtë drejtim, Cakolli vlerëson se fjalori i partive politike në



nisje të fushatës duket më i moderuar, duke përmendur në veçanti Lëvizjen Vetëvendosje.

Kush i monitoron zgjedhjet?

Kur zgjedhjet u caktuan për 28 dhjetor, disa parti e organizata në Kosovë alarmuan se zgjedhjet nuk do të mund të monitorohen nga faktori ndërkombëtar, meqë një pjesë e mirë e botës është në periudhë festash ato ditë.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, thotë për REL-in se në grupin e parë të vëzhguesve të akredituar më 16 dhjetor ka përfaqësues të mediave vendëse e ndërkombëtare, përfaqësues të ambasadave britanike e japoneze, dhe të organizatave joqeveritare vendëse.

Cakolli pohon të ketë mësuar se

misioni i Bashkimit Evropian do të jetë shumë më i kufizuar në numër këtë herë, ndërsa rrjeti i organizatave Demokracia në Veprim pritet të jetë më i madhi - me rreth 600 vëzhgues dhe vullnetarë të angazhuar - për monitorimin e procesit. “Normalisht, vëzhgimi ndërkombëtar është vlerë e shtuar e procesit, por nuk besoj se është përcaktues në integritetin e vetë procesit zgjedhor”, shprehet ai.

Procesi zgjedhor

Në këto zgjedhje, të drejtë vote do të kenë mbi 2 milionë shtetas të Kosovës, brenda dhe jashtë vendit.

Sikur edhe më 9 shkurt, diasporës i është ofruar mundësia që të votojë me postë - në periudhën 12-27 dhjetor - apo në 37

përfaqësi diplomatike në 24 shtete të ndryshme, më 27 dhjetor.

Në këtë proces zgjedhor do të marrin pjesë 24 subjekte politike, me 1.180 kandidatë.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, votuesi ka të drejtë të zgjedhë deri në 10 kandidatë për deputetë nga një subjekt politik.

Rastet kur fletëvotimi shpallet i pavlefshëm është kur votuesi voton më shumë se një subjekt politik apo kur voton vetëm për kandidatët për deputetë, dhe jo edhe për subjektin politik.

Deri në atë ditë, premtimet e kandidatëve për t'u ngjitur në pushtet do të jenë të pranishme në çdo platformë të mundshme. Orët e vona të 28 dhjetorit do të japin më shumë qartësi nëse Kosova do ta shmangë një paralizë të mundshme...

rajon por, pavarësisht këtij përmirësimi, nivelet e varfërisë dhe papunësisë në Ballkanin Perëndimor mbeten më të larta se në vendet fqinje të BE-së.

Gjithashtu, theksohet se “korrupsioni, përfshirë edhe tek udhëheqësit kryesorë politikë, vazhdon ta prekë Ballkanin Perëndimor dhe përbën një nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe politik të rajonit”, ndërsa “fushatat e dezinformimit të drejtuara ndaj Ballkanit Perëndimor minojnë besueshmërinë e institucioneve demokratike, përfshirë integritetin e zgjedhjeve”.

Për këtë arsye, Kongresi ka theksuar se ShBA-ja duhet, ndër të tjera, të bashkëpunojë me aleatët dhe partnerët e përkushtuar për forcimin e sundimit të ligjit,

diversifikimin e burimeve energjetike, reformat demokratike dhe ekonomike dhe reduktimin e varfërisë; ta nxisë forcimin e lidhjeve tregtare dhe investimeve midis ShBA-së dhe aleatëve/partnerëve në Ballkanin Perëndimor dhe ta zgjasë ndihmën amerikane për përpjekjet e integritetit rajonal në rajon.

ShBA-ja duhet ta mbështesë anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor që nuk janë pjesë e BE-së dhe NATO-s, dhe që duan të anëtarësohen, t'i përmbushin kriteret për anëtarësim, kanë mbështetjen e të gjithë aleatëve për ta marrë ftesën për anëtarësim dhe që janë në gjendje t'i promovojnë më tej parimet e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në

sigurinë kolektive të NATO-s.

ShBA-ja duhet t'i rrisë lidhjet tregtare dhe investimet në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht për ta zvogëluar varësinë nga burimet energjetike ruse, për ta rritur diversifikimin e energjisë, efikasitetin dhe kursimin, si dhe për ta lehtësuar kalimin të burimet e energjisë së pastër. Aty shtohet se duhet të vazhdojë mbështetja e zhvillimit të shoqërisë civile të fortë, partneriteteve publike-private, medias së pavarur, qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme, stabilitetit politik dhe ekonomive moderne të tregut.

Në aktin për mbrojtjen, sekretarit të Shtetit, Marco Rubio, i kërkohet të nxisë iniciativa për zhvillim demokratik dhe ekonomik dhe prosperitet,

përfshirë zgjatjen e ndihmës teknike në çdo vend të Ballkanit Perëndimor, duke marrë parasysh kushtet lokale dhe miratimin e qeverisë vendase; t'i forcojë strategjitë kombëtare ekzistuese kundër korrupsionit, përfshirë korrupsionin politik, veçanërisht në gjyqësor, organet e pavarura të mbikëqyrjes së zgjedhjeve dhe prokurimet publike dhe ta promovojë rolin e medias së pavarur në luftën kundër korrupsionit.

Kongresi, gjithashtu, ka shprehur mbështetje për sigurinë kibernetike dhe rezistencën kibernetike në Ballkanin Perëndimor, iniciativat për lidhje ekonomike rajonale dhe zhvillim, si dhe për promovimin e bashkëpunimit ndërkulturor dhe arsimor midis ShBA-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Autori i këtij dokumenti për Ballkanin Perëndimor, anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve nga radhët e demokratëve, William Keating, tha për “Insajder”-i se miratimi i legjislacionit në dy dhomat e Kongresit tregon se Ballkani mbetet në radarin amerikan.

“Mesazhi i rëndësishëm është se Amerika vazhdon të jetë e interesuar për Ballkanin Perëndimor. Unë merrem me këtë rajon prej shumë vitesh dhe gjithmonë e kam konsideruar si një zonë të rëndësishme për ne. Njerëzit duhet ta dinë se edhe në këtë Qeveri të ShBA-së ka njerëz që e shohin Ballkanin si prioritet”, tha Keating. Ai shpjegoi se legjislacioni u paraqit që në shtator, më pas u përfshi në Aktin për mbrojtjen, me qëllim që të sigurohet miratimi i tij.

Ngrihet aktakuzë ndaj katër personave për kontrabandim të migrantëve

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj katër personave për kontrabandim të migrantëve. A. K., F. L., V. P., B. C. po ashtu akuzohen për veprën “pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal të organizuar”. Sipas Prokurorisë, të pandehurit së bashku me persona të tjerë të pidentifikuar, nga janari i vitit 2023 deri në shtator të këtij viti, kishin vepruar si grup i

organizuar kriminal, duke futur kundërligjshëm shtetas të huaj në territorin e Kosovës. Aktakuza thotë se ata kishin marrë para në këmbim të kontrabandimit të migrantëve në Kosovë, nga 100 deri në 300 euro për person. Migrantët, që vinin përmes Shqipërisë nga shtete sikurse Bangladeshi, Pakistani, Siria dhe vende të tjera, destiacion final kishin shtetet e Evropës. Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që merret me

kontrabandim të migrantëve mund të dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Ndryshe, ligjet lejojnë qëndrimin e migrantëve në Kosovë vetëm deri në 15 ditë pa u lajmëruar tek autoritetet e rendit. Pas 15 ditësh ai duhet të aplikojë për statusin e azilkërkuesit, në të kundërtën duhet të largohet nga territori i Kosovës. Për ta fituar statusin e azilit, duhen disa muaj kohë.



GJENDEN MBETJE MORTORE NË RAHOVEC QË DYSHOHET SE MUND T’U PËRKASIN VIKTIMAVE TË LUFTËS

RAHOVEC, 19 DHJETOR - Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur njoftoi se për dy ditë me radhë ka kryer gërmime në një lokacion në rajonin e Rahovecit, ku janë gjetur mbetje mortore, që dyshohet se mund t’u përkasin viktimave të luftës. Sipas njoftimit, dje në lokacionin që njihet nga banorët lokalë si Përzehina dhe që gjendet afër varrezave të qytetit u gjetën dy pjesë eshtërore që janë dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për ekzaminim. Ndërkaq u gjetën “mbetjet mortore të të paktën një individi”

që mund t’u përkasin viktimave të luftës që mund të jenë në listën e personave të zhdukur. “Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe institucionet e tjera të angazhuara në këtë proces, mbeten të përkushtuara në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe në informimin e rregullt të opinionit publik, duke respektuar ndjeshmërinë e procesit dhe dinjitetin e viktimave dhe familjeve të tyre”, u tha në njoftim. Muajt e fundit janë kryer gërmime në disa lokacione, ku janë gjetur mbetje mortore që



dyshohet se u përkasin personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998/99. Në shtator, në lokacionin e quajtur Lugjet e Nekës, në Bjeshkët e Strellcit u gjetën mbetje mortore. Ndërkaq në

tetor, në Hajvali të Prishtinës u gjetën mbetje eshtërore që dyshohet se u përkasin të paktën katër personave të zhdukur gjatë luftës. Atëbotë kreu i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Andin Hoti, deklaroi se gjatë këtij viti nga gërmimet e kryera në mbarë Kosovën, ishin gjetur “mbetje mortore në 12 lokacione”. Gjatë luftës së fundit në Kosovë janë vlarë afër 13 mijë persona, ndërkaq afër 1 600 vazhdojnë të jenë të zhdukur. Shumica e viktimave ishin civilë shqiptarë. Kosova dhe Serbia patën arritur

pajtueshmëri më 2023 për Deklaratën e përbashkët për personat e zhdukur, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Kjo deklaratë përmbante zotime për qasje të plotë në informacione të besueshme, përfshirë ato të klasifikuara, qasja në dokumente me rëndësi për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe krijimin e një komisioni për këtë çështje të kryesuar nga Bashkimi Evropian. Megjithatë, kjo deklaratë ende nuk është zbatuar.

QEVERIA NIS PROCEDURAT PËR NGRITJEN E MEMORIALIT PËR FAMILJEN JASHARI DHE EPOPENË E UÇK-së NË ITALI



PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka bërë me dije të premtën për nisjen e procesit për ngritjen e një memoriali për familjen Jashari dhe Epopenë e UÇK-së në bashkinë Hora e Arbëreshëve në Itali. “Dy pika të tjera me rëndësi sot te të ndryshmet janë: vendimi në lidhje me Memorialin e Familjes Jashari dhe Epopenë e UÇK-së në Bashkinë Hora e Arbëreshëve në Itali dhe ndarja e mjeteve për Bursën e Mobilitetit për Studentë. Para një muaji e kam mirëpritur në kryeministri kryetarin e Bashkisë Hora e Arbëreshëve, z. Rosario Petta. Ndër temat që kishim diskutuar

dhe për të cilat ishim pajtuar, ishte edhe memorializimi i veprës dhe kujtimit të heroizmit të kryekomandantit tonë Adem Jashari dhe familjes së tij epike në këtë komunë arbëreshe në Itali. Sot do të themelojmë Komisionin Profesional për përzgjedhjen e artistit apo grupit të artistëve për ngritjen e Memorialit për Familjen Jashari dhe Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hora e Arbëreshëve. Memoriali do të jetë donacion i Qeverisë së Republikës së Kosovës për arbëreshët në Itali. Gjithashtu, po ndajmë 1.65 milionë euro për grupin e parë të studentëve përfituesve, rreth 10 mijë prej

tyre, të Programit të Bursës së Mobilitetit për Studentë. Siç kemi njoftuar më parë, vlera e bursave ndryshon varësisht nga distancës prej vendit ku jetojnë dhe vendi ku studiojnë studentët. Kjo bursë synon që të zvogëlojë pabarazitë dhe të krijojë mundësi edhe për ata studentë, që vijnë nga zonat e largëta e që për ta studimet do të ishin më të kushtueshme. Me këtë është përmbushur qysh tash një nga premtimet e Qeverisë sonë për mandatin e ardhshëm. Duke qenë Qeveri në detyrë, tashmë po kryejmë edhe detyra të së ardhmes”, ka thënë Kurti.

Policia në rajonin e Mitrovicës së Jugut mban ligjërata në shkolla për rreziqet e përdorimit të mjeteve piroteknike

MITROVICË E JUGUT, 19 DHJETOR - Meqenëse përdorimi i mjeteve piroteknike është bërë dukuri e zakonshme gjatë festave të fundvitit, policia në rajonin e Mitrovicës së Jugut ka filluar mbajtjen e ligjëratave nëpër shkollat e mesme të ulëta me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve për rreziqet që paraqet përdorimi i këtyre mjeteve. Fokus i ligjëratave janë rreziqet dhe pasojat nga përdorimi i mjeteve piroteknike dhe rëndësia

e sigurisë personale dhe kolektive. Përpos rreziqeve personale të përdoruesve si, p.sh; djegie, plagë të rënda në duar, këmbë, sy, fytyrë etj., ekziston edhe rreziku kolektiv pasi që shpërthimet e forta të këtyre mjeteve shkaktojnë trauma dhe pasoja psikologjike te shumë qytetarë, gjithashtu ekziston rreziku permanent i shkaktit të zjarreve në shtëpi, banesa apo hapësira publike duke rrezikuar jetën dhe pronën e shumë

qytetarëve. Mbajtja e këtyre ligjëratave dhe aktiviteteve vetëdijesuese do të vazhdojë edhe në ditët në vijim deri në prag të festave të fundvitit. Policia, gjithashtu, u bënë thirrje qytetarëve që të festojnë në mënyrë të sigurt dhe të përmbahen nga përdorimi i mjeteve piroteknike pasi që për një argëtim të përkohshëm nuk ia vlen që të rezikohet shëndeti i përdoruesve si dhe siguria e qytetarëve.



FSK-ja realizon trajnimin “Simboli i Ujkut”

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Trajnimi elitë “Simboli i Ujkut” është përfunduar me sukses pas tre javësh intensive dhe të mbushura me sfida të vazhdueshme. Ky trajnim selektiv kishte për qëllim testimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale, fizike dhe mentale të pjesëmarrësve.

Ushtrimi final zgjati 72 orë pa ndërprerje, gjatë të cilit kursantët realizuan patrullime mbi 70 kilometra me pajisje të plota ushtarake. Në fazën përfundimtare ata ekzekutuan me sukses misionin e caktuar, sulmin duke treguar profesionalizëm të lartë, vendosmëri, si dhe

bashkëpunim të shkëlqyer ekipor. Përfundimi me sukses i këtij trajnimi konfirmon nivelin e lartë të përgatitjes dhe gatishmërisë së pjesëtarëve si dhe angazhimin e vazhdueshëm për ngritjen e kapaciteteve operative dhe profesionale.



JUSTINA SHIROKA-PULA BËHET GRUAJA E PARË NË KRYE TË ASHAK-ut

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 19 dhjetor 2025 ka mbajtur zgjedhjet e rregullta për zgjedhjen e Kryesisë së Akademisë.

Në njoftimin për medie bëhet me dije se kryetare është zgjedhur Justina Shiroka-Pula, nënkryetar Fejzullah Krasniqi dhe sekretar shkencor Bardh Rugova. Kjo është hera e parë që në krye të ASHAK-ut është zgjedhur një grua.

Kuvendi i Akademisë, gjithashtu, miratoi zgjedhjen e sekretarëve të seksioneve: anëtar korrespondent Nysret Krasniqi, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë; akademik Frashër Demaj, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore; anëtar korrespondent Enver Hamiti, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës; anëtar korrespondent Ismet Jonuzi, sekretar i Seksionit të Arteve.

Biografia e Justina Shiroka-Pula

Lindi më 1953 në Prishtinë. Shkollimin fillor (1968) dhe të mesëm (1972) i kreu në Prishtinë. Diplomoi me sukses në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë në vitin 1976. Studimet pasuniversitare, në fushën e Teorisë dhe politikës së zhvillimit ekonomik, i vijoi në Fakultetin e Shkencave Ekonomike të Zagrebit, ku diplomoi në vitin 1984. Doktoroi në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës (1977), duke mbrojtur tezën e doktoratës me titull “Investimet demografike dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës”.

Pas diplomimit u punësua në Bankën Popullore të Kosovës (1977), pastaj hyri në procesin mësimor në Fakultetin Ekonomik (1978), ku vazhdon



edhe sot karrierën akademike. Ajo fillimisht u punësua asistente për lëndën “Kërkimet operacionale”, pastaj u avancua në thirrjen e ligjëruesit, docentit (1978) dhe profesorit ordinar (2004). U angazhua në një fushë të re, ku edhe kuadri mësimor dhe shkencor ishte deficitar, në fushën e kërkimeve operacionale, përkatësisht në fushën e zbatimit të metodave dhe modeleve matematikore dhe statistikore në planifikimin dhe në optimizimin e proceseve biznesore, duke e zgjeruar fushën e saj të interesimit, më vonë, edhe në zbatimin e këtyre metodave në zgjidhjen e problemeve të zhvillimit të bizneseve, në menaxhment dhe në procesin e marrjes së vendimeve. Në këtë aspekt, ajo u zhvillua në vazhdimësi në një karrierë shumë të pasur, përgjatë tërë kësaj periudhe, në

Fakultetin Ekonomik, prej vitit 1978 e deri sot. Mund të thuhet se ajo ka pasur një rol prej një pionieri për zhvillimin e fushës së kërkimeve operacionale, jo vetëm në këtë fakultet, por edhe më gjerë në Kosovë, nëpërmjet mësimdhënies në studime bazike dhe master, e sidomos nëpërmjet udhëheqjes së studentëve në punimet e diplomës, në tezat e masterit dhe në tezat e doktoratës.

Në Fakultetin Ekonomik ka qenë kryesuese e Departamentit të Matematikës dhe Statistikës (1999), kryetare e Bordit të masterit në Menaxhment Shëndetësor (2002), anëtare e Senatit të UP-së (2000) dhe anëtare e Bordit të UP (2001), anëtare e Komisionit të Universitetit Veror të Prishtinës (2002). Është anëtare e Këshillit të Fushës Shkencore-Burimet Natyrore, Energjia dhe Mjedis

(2011) në MASHT, anëtare e Këshillit Botues të UP “Hasan Prishtina” (2013). Është anëtare e Këshillit Shkencor për njohje e barasvlerë të diplomave (2016), në MASHT dhe anëtare e Komisionit për Ekonomi të Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut (2017). Krahas studimeve të rregullta, ajo ka punuar në zhvillimin e saj të vazhdueshëm në aspektin kërkimor-shkencor dhe profesional, duke marrë pjesë në studime të pasdoktoratës në kuadër të këmbimit ndëruniversitar, Universiteti i Lincit në Austri (2013) dhe Universiteti i Arizonës në SHBA (2013), si dhe në trajnime dhe përsosje profesionale: Menaxhimi në sistemin e kujdesit shëndetësor, Itali (2002), Hulumtimi i programeve dhe përgatitja e teksteve mësimore, Belgjikë (2004), Çështjet e

zhvillimit të biznesit dhe sipërmarrësisë, SHBA (2003) dhe shumë trajnime e specializime në vend.

Aktivitetin akademik e ka ushtruar edhe jashtë vendit. Në vitet 1994-99 ka ligjësuar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës dhe në vitet 2003-2004, në UEJL-Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë.

Pas luftës (që nga vitet 2001-2005), ka zhvilluar edhe një aktivitet të admirueshëm me shoqërinë civile, në fushën e fuqizimit të gruas, barazisë gjinore dhe në zhvillimin e bizneseve dhe të ndërmarrësisë: Themeluese e Rrjetit të Biznesit të Grave Kosovare-KBWN (2001), Anëtare e Star Network of World Learning-Washington (2001), Eksperte lokale e Grupit Punues në Ekonomi të Qendrës Evropiane për Çështjet e Minoriteteve –ECM (2001), Anëtare e grupit punues-Nisma Kosovare për Barazi Gjinore (2002), Anëtare e Aleancës Ndërkombëtare të Grave (2003). Ajo ka udhëhequr bordet e disa OJQ-ve nga kjo fushë dhe, që nga viti 2012, është edhe anëtare e Bordit të Qendrës Shqiptare për Studime Strategjike në Tiranë.

Përveç angazhimit në Fakultetin Ekonomik dhe në UP, ka dhënë një kontribut shumë të vlefshëm në funksione të rëndësishme publike, midis të cilave shquhet puna e saj si Ministre e Energjisë dhe Minerave në Qeverinë e Kosovës (2008-2011) dhe si Deputete në Kuvendin e Kosovës (2011-2014).

Në vitin 2016 është zgjedhur anëtare korrespondente e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. ndërsa nga vitin 2018 është sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe me automatizëm anëtare e kryesisë të Akademisë. Në vitin 2020 u zgjodh anëtare e rregullt-akademike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Miratohet Plan i Zhvillimit Profesional për Stafin e AKA-së

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka miratuar Planin e Zhvillimit Profesional për Stafin, në një punëtori të organizuar me fokus në forcimin e kapaciteteve profesionale, teknike dhe

organizative për periudhën trevjeçare 2026-2028. Ky plan strategjik synon rritjen e cilësisë së punës së stafit përmes zhvillimit të kompetencave profesionale, përdorimit të avancuar të platformave

digjitale të AKA-së, fuqizimit të komunikimit profesional me institucionet e arsimit të lartë (IAL) si dhe harmonizimit të punës me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG 2015).



AKB-ja pranohet zyrtarisht në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (EESC)

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka njoftuar opinionin publik se është pranuar zyrtarisht si Enlargement Candidate Member (ECM) në kuadër të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (EESC), një nga institucionet kryesore këshillëdhënëse të Bashkimit Evropian për dialogun social dhe zhvillimin ekonomik. Ky vendim përfaqëson një

njohje të rëndësishme institucionale për rolin e AKB-së si përfaqësuese e komunitetit të biznesit në Kosovë dhe si aktore e rëndësishme në ndërtimin e dialogut social ndërmjet bizneseve, punëtorëve dhe institucioneve publike, në sektorin privat dhe publik. Statusi ECM i mundëson AKB-së pjesëmarrje aktive në proceset konsultative të EESC-

së, duke kontribuar në politikat evropiane që lidhen me ekonominë, tregun e punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm si dhe në procesin e integritimit evropian të Kosovës. AKB-ja e konsideron këtë përzgjedhje si përgjegjësi shtesë për ta fuqizuar dialogun social dhe për ta përfaqësuar Kosovën me dinjitet dhe profesionalizëm në institucionet e Bashkimit Evropian.



“NDËRTIMTARIA ËSHTË INFUZIONI I EKONOMISË”, FATON HOXHA TREGON PSE KËRKESA PËR BLERJE BANESASH NUK PO BIE NË KOSOVË

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Sektori i ndërtimtarisë vazhdon të jetë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së Kosovës, ku rreth 12 për qind e të punësuarve janë në këtë sektor. Kështu tha në “Përballje Podcast” në Telegraf, Faton Hoxha, kryetar i Shoqatës së Ndërtuesve të Kosovës, duke folur për rolin e ndërtimtarisë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe trendet e vazhdueshme të ndërtimit. Ai tha se ndërtimi nuk pritet të ndalet për aq kohë sa ekziston kërkesë reale për banesa. “Ndërtimi ka qenë dhe mbetet infuzioni i ekonomisë sonë. Ende është diku te një e gjashta e GDP-së së Kosovës dhe rreth 12 për qind e të punësuarve janë në këtë sektor”, tha Hoxha. Ai theksoi se zhvillimi i ndërtimtarisë pas luftës ka qenë i domosdoshëm për shkak të rritjes së popullsisë dhe mungesës së infrastrukturës



bazë, duke përfshirë jo vetëm objektet banesore, por edhe rrugët, shkollat, spitalet dhe infrastrukturën publike në përgjithësi. Sipas Hoxhës,

ndërtimi sot nuk është i përqendruar vetëm në Prishtinë, por është shtrirë në të gjitha regionet e Kosovës. “Në secilin prej regjioneve të Kosovës ka

bom ndërtimi - Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan dhe Ferizaj”, u shpreh ai. Duke komentuar debatet për një ndalim apo ngadalësim të

ndërtimit për shkak të numrit të lartë të banesave të pabanueshme, Hoxha tha se këto interpretime nuk pasqyrojnë realitetin e tregut. “Në momentin që nuk ka shitje, nuk ka as ndërtim. Përderisa ka blerës dhe kërkesë reale, ndërtimi nuk do të ndalet”, theksoi ai. Ai shtoi se dhënia e lejeve të reja ndërtimore dhe vazhdimi i projekteve të mëdha tregojnë se kërkesa për banesa vazhdon edhe përtej qendrës së kryeqytetit. Në përmbyllje Hoxha vlerësoi se ndërtimtaria do të vazhdojë të mbetet faktor kyç i zhvillimit ekonomik të Kosovës, pavarësisht prej sfidave me planifikimin urban, infrastrukturën dhe kostot e ndërtimit. Në këtë podcast ai ka folur edhe për legalizimet, cilësinë e ndërtimit të banesave dhe tema të tjera.

AUDITORJA E PËRGJITHSHME TAKOI PËRFAQËSUESIT E ZYRËS SË BE-së NË KOSOVË



PRISHTINË, 19 DHJETOR - Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka pritur në takim udhëheqësen e ekipit të Qeverisjes së Mirë në kuadër të Projektit Reforma në Administratën Publike / Menaxhimi i Financave Publike në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Laura Fallavollita. Takimi u mbajt në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe me qëllim të informimit të dyanshëm lidhur me zhvillimet e fundit. Auditorja e përgjithshme

mirëpriti vendimin e Bashkimit Evropian për heqjen e masave ndaj Kosovës, në veçanti mbështetjen e planifikuar për Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA). Ndërsa Fallavollita foli për hapat e ardhshëm dhe rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm në proceset vijuese. Gjatë takimit u diskutua, gjithashtu, për aktivitetet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, me fokus në zbatimin e Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026 dhe forcimin e bashkëpunimit me

partnerët ndërkombëtarë në funksion të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të auditimit publik. Në takim morën pjesë edhe zëvendësauditoret i përgjithshëm Beza Halilaj dhe ndihmësauditoret e përgjithshme Myrvete Gashi. Nga Zyra e BE-së ishin Burbuqe Kelmendi, menaxhere projekti /koordinatore binjakëzimi dhe Edon Kalludra menaxher i projektit.

Bie numri i përfituesve të pensioneve invalidore të punës

PRISHTINË, 19 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin nëntor 2025. Në muajin nëntor 2025 krahasuar me muajin nëntor 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-29,3 %); skema për

pensionet e Trepçës (-19,8 %); skema për pensionet familjare (-10,9 %); skema e ndihmës sociale (-10,7 %); skema e pensioneve kontribut-paguesve të moshës (-1,8 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,4 %). Në muajin nëntor 2025,

krahasuar me muajin nëntor 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike (13 %); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (12,6 %); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (8 %); skema

e pensioneve bazike të moshës (7,4 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (4 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrotjtëse të Kosovës (TMK)



(0,9 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (0,7 %); skema për veteranët e luftës (0,2 %).

UKRAINA GODET “VRIMËN E ZEZË” TË MOSKËS: DRONI QË FUNDOSI SIGURINË RUSE NË DETIN E ZI

Shërbimi i Sigurisë i Ukrainës (SBU) dyshohet se ka dëmtuar rëndë një nëndetëse ruse të klasës Kilo në Novorossijsk, duke përdorur një dron të ri nënujor “Sub Sea Baby”. Një goditje strategjike që ul kapacitetet e lëshimit të raketave Kalibr dhe shënon debutimin operacional të UUV-ve vrasëse



Gjatë ditës së djeshme, Shërbimi i Sigurisë i Ukrainës (SBU) ka goditur, me shumë gjasa duke i shkaktuar dëme të rënda, një nëndetëse ruse të klasës 636.3 (ose “Kilo i përmirësuar II” sipas kodifikimit të NATO-s) në portin e Novorossijsk-ut, i cili është shndërruar në qendrën kryesore të operacioneve të Flotës Ruse të Detit të Zi, për shkak të pamundësisë faktike të përdorimit të Sevastopolit në Krime.

Sulmi u krye përmes përdorimit të një droni nënujor (UUV – Unmanned Underwater Vehicle) të një tipi të ri, të quajtur “Sub Sea Baby”. Ky dron, që mendohet të jetë një derivat i “Sea Baby”-t, mjet kamikaz pa pilot, ka shumë gjasa të funksionojë si një lloj torpedoje autonome. Nëse kjo hipotezë është e saktë, është e mundur që droni të drejtohet drejt objektivit përmes një rruge të paraprogramuar dhe që sistemet e tij të marrin kontrollin autonom në fazën përfundimtare, duke u orientuar vetë drejt objektivit. Kjo mund të shpjegojë se si “Sub Sea Baby” ka arritur të lundrojë brenda bazës detare,

një itinerar që kërkon manovra të shumta në hapësira të ngushta dhe që presupozon informacione të përditësuara së fundmi, në mos në kohë reale, të inteligjencës për të njohur pozicionin e objektivit dhe pengesat e mundshme. Nuk është e qartë nëse arma funksionon plotësisht në mënyrë të pavarur pas lëshimit apo nëse ekziston ende ndonjë formë drejtimi në kohë reale.

Veprimi i kryer nga SBU është i rëndësishëm për të paktën dy arsye, por fillimisht vlen të ndalemi te karakteristikat e nëndetësës ruse të goditur.

Nëndetëset “vrimë e zezë”

Nëndetëset e klasës “Kilo e përmirësuar II” janë mjete me propulsim dizel/elektrik, të tipit hunter/killer (SSK), të afta për të lëshuar raketa lundruese për sulme tokësore dhe detare, si “Kalibr”. Flota Ruse e Detit të Zi ka qenë aktive në këto gati katër vite lufte kryesisht përmes lëshimit të këtyre raketave ndaj objektivave me vlerë të lartë në Ukrainë, duke përdorur edhe

platforma sipërfaqësore si fregatat e klasës “Admiral Gorshkov”.

Këto nëndetëse janë relativisht të vogla (rreth 70 metra të gjata dhe 2.500 tonë zhvendosje maksimale), kanë një autonomi zhytjeje prej 400 miljesh detare dhe janë projektuar kryesisht për të luftuar anije dhe nëndetëse armike, me rolin dytësor të sulmeve tokësore falë raketave lundruese si “Kalibr”.

Në diskursin mediatik, “Kilo i përmirësuar II” quhen shpesh “vrima të zeza”, pasi konsiderohen jashtëzakonisht të heshtura gjatë lundrimit. Ato janë të pajisura me një sistem sonar të gjeneratës së re, që ofron qetësi operative dhe rreze zbulimi më të madhe. Ky variant është eksportuar edhe në vende si Vietnam dhe Algjeria, dhe është projektuar për fleksibilitet më të madh operacional dhe aftësi të shtuara stealth.

Sa nëndetëse kanë mbetur në Detin e Zi?

Gjashtë nga këto nëndetëse figuronin në regjistrin e Flotës Ruse të Detit të Zi, por vetëm

katër ndodheshin realisht në këtë det në momentin e shpërthimit të luftës (Deti i Zi është i mbyllur për tranzitin e njësive ushtarake të palëve ndërluftuese, sipas Konventës së Montreux).

Gjatë konfliktit, një nëndetëse e parë “Rostov mbi Don”, u dëmtua rëndë ndërsa ndodhej në dokun e riparimit në Sevastopol, nga një sulm raketor ukrainas në shtator 2023. Ajo që ka mbetur nga Flota e Detit të Zi, Moska ka humbur disa njësi nga sulmet e kombinuara ukrainase, përfshirë një kryqëzor, të paktën katër anije zbarkimi amfib, si dhe një sërë njësish më të vogla, përfshirë korveta raketash, është zhvendosur nga Sevastopoli në Novorossijsk, për shkak të sulmeve të vazhdueshme ukrainase. Në qershor 2024, 11 njësi sipërfaqësore dhe nëndetare kishin hedhur spirancat në portin e qytetit në rajonin Krasnodar Krai.


Një risi absolute për dronët nënujorë

Sulmi është i rëndësishëm për dy arsye kryesore. E para është

e qartë: në bilancin e luftës, neutralizimi i një platforme lëshimi për raketat “Kalibr” nënkupton uljen e kapaciteteve të sulmit tokësor me rreze të gjatë të kundërshtarit, të cilat, sa i përket nëndetësëve, tashmë janë përgjysmuar. Flota Ruse e Detit të Zi ka humbur kështu një pjesë të madhe të aftësisë së saj për sulme të fshehta dhe do të duhet të mbështetet më shumë te fregatat, me të gjitha rreziqet që kjo sjell (konsum i burimeve njerëzore dhe teknike, rritje e probabilitetit për t’u goditur).

Mbi të gjitha, sulmi ukrainas përfaqëson përdorimin e parë të suksesshëm luftarak të një droni nënujor, duke provuar se kjo kategori kërcënimi është reale dhe efektive. Megjithatë, mbeten ende të panjohura detaje thelbësore mbi mënyrën e sulmit, si niveli i ndërgjegjësimit situacional që droni posedon (apo që i ofrohet), si dhe modalitetet e lidhjes për transmetimin e të dhënave dhe komandave të navigimit dhe sulmit.

Të dhëna që, me shumë gjasa, nuk do t’i njohim kurrë plotësisht, as edhe pas përfundimit të luftës. / bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

DRITA SHKRUAN HISTORINË, SIGURON FAZËN E "PLAY-OFF"-IT NË LIGËN E KONFERENCËS

MADRID, 19 DHJETOR - Skuadra e Dritës e ka mbyllur me humbje fazën e ligës në kuadër të Ligës së Konferencës, por ka arritur ta sigurojë fazën "play-off" të kësaj gare. Në ndeshjen e xhiros së gjashtë dhe të fundit të fazës së ligës, Drita ka pësuar humbje në udhëtim nga skuadra e La Ligas, Rayo Vallecano.

Dueli i luajtur në Madrid ka përfunduar me fitoren 3:0 për Vallecanon, ekip që ishte dukshëm më i mirë se kampionia në fuqi e Kosovës. Një gol në pjesën e parë dhe dy të tjerë në të dytën ia siguruan skuadrës spanjolle fitoren ndaj Dritës. Florian Lejeune (34'), Gerard Gumbau (66') dhe Alfonso Espino (83') kanë shënuar golat për Vallecanon, ekip që, gjithashtu, e ka kaluar me sukses fazën e ligës pasi ka përfunduar në pozitën e katërt me 13 pikë. Për Dritën kjo ishte humbja e dytë rresht me rezultatin 3:0 pasi me rezultat identik ka pësuar edhe javën e shkuar në Prishtinë nga skuadra e Az Alkmaarit. Në gjashtë ndeshje të fazës së ligës, Drita ka regjistruar dy fitore, dy

barazime dhe po aq humbje, duke përfunduar në pozitën e 21-të me 8 pikë të mbledhura, të cilat ishin të mjaftueshme për të siguruar fazën "play-off". Kjo do të thotë se Drita ka siguruar edhe dy ndeshje shtesë në Ligën e Konferencës, të cilat do t'i luajë në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, kurse shorti do të tërhiqet në janar. Sigurimi i fazës "play-off" bën që Drita ta shkruajë historinë e futbollit të Kosovës pasi bëhet ekipi i parë që avancohet në fazën e eliminimit direkt në një garë të UEFA-s. Edhe klubi nga Tetova, Shkëndija, ka siguruar fazën e "play-off"-it në Ligën e Konferencës.

Ademi: Suksesi i Dritës nuk është i rastësishëm

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka uruar Dritën për suksesin e saj si klubi i parë që kalon fazën e ligës në Ligën e Konferencës. Ademi ka thënë se ky sukses nuk është i rastësishëm, por fryt i punës së palodhshme të stafit të trajnerëve, investimeve të



drejtuesve të klubit dhe përkushtimit e karakterit të treguar në fushë nga ana e futbollistëve. "Edhe pse përballja e fundit ndaj një rivali të fortë si Rayo Vallecano në Madrid nuk përfundoi me rezultat pozitiv, performanca e përgjithshme me 8 pikë të grumbulluara dëshmon

pjekurinë e skuadrës sonë kampione në këtë nivel të garave evropiane. Ky sukses i Dritës e rrit pashmangshëm prestigjin e Superligës sonë dhe shërben si shembull dhe motivim për të gjitha klubet e tjera të Kosovës. Përgëzime të singerta futbollistëve, shtabit teknik dhe drejtuesve të klubit. Ju jeni

ambasadorët më të mirë të kampionatit tonë dhe rritjes së pandalshme! Një urim i përzemërt shkon edhe për KF Shkëndija të Tetovës që, po ashtu, siguroi kualifikimin në 'play-off'. Suksesi i secilit klub shqiptar në Evropë na gëzon dhe na jep ndjenja krenarie", është thënë në urimin e Ademit.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT TË KLUBEVE PËR GARAT E UEFA-S MBAJTI TAKIMIN E RREGULLT



PRISHTINË, 19 DHJETOR - Departamenti i Licencimit të Klubeve për garat e UEFA-s ka mbajtur mbledhjen e rregullt të punës, ku është bërë analiza e procesit të kaluar si dhe janë theksuar sfidat dhe prithmëritë për procesin e ardhshëm. Në fillim të mbledhjes, menaxheri i Departamentit të Licencimit, Bajram Shala, i ka njoftuar anëtarët lidhur me ndryshimet dhe plotësimin e administratës së licencimit, ekspertët e kritereve, si dhe anëtarët e dy komisioneve që janë pjesë e këtij departamenti. Me ndryshimet e bëra, Erika Krasniqi është emëruar

zëvendësmenaxhere e licencimit, ndërsa si ekspertë të kritereve janë emëruar: Agron Shosholli - kriteri i personelit dhe administratës, Besim Ademi - kriteri sportiv, Haris Abdixhiku - kriteri infrastrukturor dhe Fis Murati - kriteri ligjor. Ndërsa pjesë e Komisionit të Shkallës së Parë është bërë juristi Bashkim Preteni, kurse në Komisionin e Shkallës së Dytë është angazhuar juristi Labinot Murati. Gjatë vijimit të mbledhjes është vënë në pah edhe bashkëpunimi i mirë me departamentet e tjera të Federatës së Futbollit të Kosovës

në mbulimin e detyrave dhe realizimin e kompetencave të Departamentit të Licencimit të Klubeve.

Kryetarët e të dy komisioneve, Naim Havolli nga Komisioni i Shkallës së Parë dhe Rexhep Kuçi nga Komisioni i Shkallës së Dytë, kanë vlerësuar përmirësimin e vazhdueshëm të klubeve, duke theksuar njëkohësisht nevojën që klubet ta trajtojnë këtë proces me seriozitet edhe më të madh, pasi ai përbën një udhërrëfyes për një organizim sa më profesional të vet klubeve dhe, si i tillë, ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të futbollit të Kosovës në përgjithësi.

Ferguson për Ronaldon: Në moshën 17-vjeçare e dija që kishte diçka të veçantë tek ai

LONDËR, 19 DHJETOR - Legjenda e Manchester Unitedit, Sir Alex Ferguson, ka hedhur dritë mbi marrëdhënien e tij me Cristiano Ronaldon, një nga lojtarët më të shquar që ka drejtuar gjatë karrierës së tij të gjatë dhe të suksesshme.

Ferguson i kishte besuar Ronaldos ende adoleshent, pas vetëm një shikimi të shkurtër gjatë kohës kur ai luante te Sporting Lisbona. "Ishte

fantastike. Në jetën tuaj profesionale takoni lojtarë të jashtëzakonshëm. Që në moshën 17-vjeçare e dija që ai kishte diçka të veçantë, jo vetëm aftësitë e tij, por edhe dëshirën për t'u bërë më i miri", ka thënë Ferguson.

Gjithashtu, ai ka theksuar punën e palodhur dhe përkushtimin e Ronaldos që nga fillimi i karrierës. "Çdo seancë stërvitore, ai praktikonte

pas goditjeve të lira. Ishte fenomenal. Ai nuk ishte thjesht i talentuar, por kishte një etje të paparë për ta përmirësuar veten çdo ditë", ka thënë Ferguson.

Më tutje, Ferguson ka folur edhe për ndikimin e Ronaldos brenda dhomës së zhveshjes dhe në fushë. "Ai ishte një shembull për shokët e skuadrës. Ambicia e tij e madhe dhe përkushtimi për stërvitje e bënë

atë një udhëheqës natyral", ka thënë Ferguson. Marrëdhënia mes Fergusonit dhe Ronaldos është shembull i mënyrës se si një trajner i madh mund të identifikojë dhe zhvillojë talentin e jashtëzakonshëm, duke ndihmuar lojtarët ta arrijnë potencialin e tyre maksimal. Sot Ronaldo konsiderohet një nga futbollistët më të mëdhenj të të gjitha kohëve, dhe Fergusoni



nuk ngurron ta pranojë se kishte parashikuar suksesin e tij që në fillim.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 18, nenin 22 dhe nenit 41 nën pika 1.13.8 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar me datë 26.02.2025 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 222/25 të datës 19.12.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L “Përparimi” Sh. A, me datë 19.12.2025 shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

- I. Titulli:** Inkasanti i vend parkingjeve
- Numri i ekzekutuesve:** 1
- Orët e punës:** 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi
- Përgatitja profesionale:** Përgatitje universitare apo shkollim i mesëm
- Përvoja e punës:** Preferohet përvoja e punës një (1) vit
- I raporton:** Udhëheqësit të Njësive të VendParkingjeve
- Koeficienti i pagës:** 442.56 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës për punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e parkingjeve publike.
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga ndërmarrja.
- Ngarkohet me fatura, inkason dhe dorëzon pazarin çdo ditë.
- Realizon normën e inkasimit sipas rregullores së ndërmarrjes.
- Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të Njësive të Vend parkimeve.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Përparimi” Sh. A - Vushtrri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 22.12.2025 deri me datë 05.01.2026 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 12.01.2026.
- Afati për ankesë nga data 13.01.2026 deri me datë 15.01.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 29.01.2026.
- Afati për ankesë nga data 30.01.2029 deri me datë 02.02.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 09.02.2026.
- Afati për ankesë nga data 10.02.2026 deri me datë 16.02.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 27.02.2026.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Përparimi” Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. “Gjergj Kastriot Skënderbeu” nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Përfundim

N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bashkim Muhaxhiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Tekstil Gjakovë.
- Agim Berhani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Dëshmorët e Kombit” Korish Prizren.
- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.I. me nr. Unik: 811133719.
- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greçevci”.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjinnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjinnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sal-lon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informa-ta lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 7/129
Dt. 18.12.2025

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023, KLASËT E
10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË PROFESIONAL –
MESIMI PËR TË RRITUR

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e
dhjetë (10) në
Qendren e Kompetenes në Prizren, **shpallim këto drejtime:**

	<u>I.</u> Ekonomi		
1	Nepunes Industrie	1 Paralele	24 nxënës
	<u>II.</u> Tregti		
1	Sherbimet ndaj konsumatorit	1 Paralele	24 nxënës
	<u>III.</u> Turizem		
1	Asistent ne organizimin e eventeve	1 Paralele	24 nxënë

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimit për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2025/2026, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe qe janë më të vjetër se 19 vjeç.
Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet 10 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në administratën e shkollës Qendren e Kompetenes në Prizren, nga ora 08:00-14:00.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “RTG Dental” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811989708 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “RTG Dental” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811989708 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “RTG Dental” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811989708 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

